



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 82 Akti

Nr. 615 Vendimi

Tiranë, më 23.1.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj **Kryesues**

Olsi Komici **Relator**

Suela Zhegu **Anëtare**

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 20.1.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Irma Balli**, prokurore/Drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoji subjektin e rivlerësimit Irma Balli në seancë publike, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe dëgjoji vëzhguesin ndërkombëtar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Irma Balli ushtron detyrën e prokurores pranë Prokurorisë së Apelit Korçë, duke qenë njëkohësisht edhe drejtuese e kësaj Prokurorie dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me vendimin nr. 14, datë 15.6.2021, ka vendosur:
 - i. Të prishë vendimin nr. 109, datë 19.2.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli.
 - ii. Të urdhërojë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Irma Balli edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
3. Në zbatim të këtij vendimi, po i njëjti trup gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 4.10.2021 ka vendosur të riçelë hetimin me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Irma Balli dhe të kryejë procesin e rivlerësimit edhe për dy kriteret e tjera, kriterin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional.
4. Bazuar në nenet 39, 42 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse si: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.
5. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar u caktua z. Theo Jacobs.
6. Trupi gjykues, me vendimin e datës 13.12.2022, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Irma Balli, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për kalimin e barrës së provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe mbi të drejtën për të dhënë shpjegime e për të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda datës 28.12.2022; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40, 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë

subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

7. Me *email*-in datë 28.12.2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë trupit gjykues prapësimet e saj dhe provat bashkëlidhur në lidhje me rezultatet e hetimit.

8. Me vendimin datë 10.1.2023, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Irma Balli në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike, në datën 11.1.2023, e njoftoi se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 16.1.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë.

9. Me *email*-in datë 13.1.2023, subjekti njoftoi Komisionin se për arsye shëndetësore nuk mund të paraqitej në datën e caktuar për seancë dëgjimore dhe kërkoi shtyrjen e seancës.

10. Me *email*-in datë 13.1.2023, Komisioni njoftoi subjektin se e pranoi kërkesën e saj dhe e ftoi për seancën dëgjimore të datës 20.1.2023, ora 10:00.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Në datën 20.1.2023, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore me prezencën e subjektit të rivlerësimit.

12. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Teo Jacobs.

13. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ajo parashtroi shpjegimet e saj dhe i depozitoi me shkrim pranë Komisionit.

14. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Irma Balli kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit Irma Balli ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit dhe fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

17. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të

mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. KONTROLLI I FIGURËS

18. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka dërguar pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Irma Balli, i padeklasifikuar. Pas kërkesës së Komisionit për deklasifikimin e tij, DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2022, ka njoftuar Komisionin se KDZH-ja, me vendimin nr. ***, datë 10.10.2022, ka vendosur të mos deklasifikojë raportin nr. ***, datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Irma Balli, klasifikuar “sekret”.

19. Sa më sipër, Komisioni, pasi u njoh me përmbajtjen e informacionit të padeklasifikuar dhe kreu një hetim të mirëfilltë, të pavarur dhe të pandikuar nga përfundimet e Grupit të Punës në DSIK, vlerësoi që të mbajë në konsideratë këtë informacion në vlerësimin tërësor të subjektit, bazuar edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga organet ndihmëse të procesit të rivlerësimit dhe të tjera.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

20. Në prapësimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk ka vlerësim nga Komisioni për figurën e saj, duke prezumuar se është e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si prokurore. Deklarata për kontrollin e figurës (shtojca 3) është plotësuar në mënyrë të saktë e me vërtetësi dhe nuk është deklaruar asnjë kontakt i papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe nuk është vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

21. Në referim të dispozitave të përcaktuara në Aneksin e Kushtetutës (neni DH) dhe në ligjin nr. 84/2016 (nenet 34 e 38 të ligjit nr. 84/2016, pika 1 e nenit 39) që kanë lidhje me kontrollin e figurës, subjekti pretendon se në mënyrë të qartë e të sigurtë nuk gjendet në asnjë nga situatat e sipërpërmendura si rrethana për të vlerësuar negativisht figurën e saj. Subjekti citon edhe faktin që në datën 7.3.2017 është pajisur me certifikatë sigurie me afat 5-vjeçar, që është rrjedhojë e një hetimi mjaft të hollësishëm të personit të saj dhe të familjes në drejtim të kërkesave të ligjit.

22. Në përfundim, në seancë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit u shpreh se ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, prandaj i kërkoi trupit gjykues që të mbajë në konsideratë praktikën e Kolegjit sipas vendimit nr. 1, datë 15.1.2020.

Vlerësimi i Komisionit

23. Komisioni, pasi mori në konsideratë dhe vlerësoi përmbajtjen e informacionit të padeklasifikuar, në respektim të vendimit nr. ***, datë 10.10.2022, të KDZH-së, të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’”, i ndryshuar, si dhe të standardeve dhe konkluzioneve të vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen “Regner kundër Republikës Çeke”, të çështjeve të caktuara me burim nga institucionet, si edhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, arrin në konkluzionin se:

- a) nuk provohet që subjekti të ketë pasur kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo të jetë vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe nuk është në kushtet e përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenet 34 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016;
- b) në sjelljen e subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar problematika thelbësore që mund të sillnin si pasojë cenimin e besimit të publikut te drejtësia.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Irma Balli ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

B. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

24. Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin etiko-profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar raportin¹ mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Irma Balli, Drejtuese e Prokurorisë së Apelit Korçë.

25. Ky raport, për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional, për të cilat Grupi i Punës ka konkluduar me një vlerësim pozitiv për subjektin e rivlerësimit².

¹Raporti nr. *** prot., datë 12.4.2018, i Prokurorisë së Përgjithshme.

²1) Aftësitë profesionale, ku përfshihen *njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor* – subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore (të sjella nga subjekti) dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti: identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet e zbatimit të saj; analizon dispozitat ligjore penale të zbatueshme në raport me provat dhe faktet; bën referim të saktë në vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; ka aftësi në arsyetimin ligjor; aktet e hartuara nga subjekti janë të arsyetuara mirë, të kuptueshme dhe respekton rregullat e drejtshkrimit.

2) Aftësitë organizative, ku përfshihen: (a) *aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – gjatë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, subjekti ka ushtruar detyrën e drejtueses së Prokurorisë së Apelit Korçë, duke përfaqësuar organin e akuzës në gjykim dhe duke kontrolluar veprimtarinë e kësaj prokurorie. Subjekti, në periudhën e rivlerësimit 2014 – 2016, ka trajtuar gjithsej 795 çështje, nga të cilat ka përfunduar 790 çështje dhe 5 prej tyre i ka bartur në vitin 2017. Subjekti ka zbatuar kompetencat që ligji i njeh prokurorit, ka respektuar afatet procedurale dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve; (b) *aftësia për të kryer procedurat e përfaqësimit në gjykatë* – konstatohet se subjekti tregon profesionalizëm në gjykim dhe në qëndrimin që mban për çështjet në gjykim, është produktive dhe dokumenton mirë veprimet procedurale; (c) *aftësia për të administruar dosjet* – në dosjet e vëzhguara paraqet aftësi për të administruar dosjet dhe të gjitha aktet që përfshihen në të. Nuk vërehen mangësi në anën formale të akteve.

3) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, ku përfshihen: (a) *etika në punë*; (b) *integriteti*; dhe (c) *paanësia*. Subjekti përmbush angazhimet profesionale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të saj, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Nga të dhënat dhe aktet e vëzhguara nuk janë evidentuar të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm; nuk ka pasur masa disiplinore; nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit dhe as shkaqe anësie të dokumentuara dhe, si rrjedhojë, ndaj saj nuk është kërkuar përjashtimi nga përfaqësimi i çështjeve në gjykim; nuk ka pasur përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që vënë në dyshim paanësinë e subjektit dhe as raste të përdorimit të cenimit të të drejtave të palëve e viktimave.

4) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, ku përfshihen: (a) *aftësitë e komunikimit*; (b) *aftësia për të bashkëpunuar*; dhe (c) *gatishmëria për t'u angazhuar*. Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se subjekti shfaq aftësi

26. Raporti gjithashtu është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e informacioneve si vijon:

B/1. FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

27. Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i nënshkruar pa mangësi nga subjekti, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, i plotë dhe me dokumentacionin e nevojshëm, bashkëlidhur: certifikatat dhe vërtetimet për trajnime të subjektit në Shkollën e Magjistraturës dhe jashtë saj; si dhe dy akte “vlerësimi i punës” për vitet 2015 dhe 2016 nga Prokurori i Përgjithshëm me vlerësimin “shumë mirë”.

28. Rezulton³ se subjekti i rivlerësimit: në periudhën 1.9.1987 –15.3.1994 ka mbajtur detyrën e hetueses në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë; në periudhën 16.3.1994 – datë 19.2.1999 ka mbajtur detyrën e zv/prokurores së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë; nga data 20.2.1999 deri aktualisht mban detyrën e Drejtueses së Prokurorisë së Apelit Korçë.

29. Rezulton se gjatë 3 viteve të fundit të ushtrimit të detyrës, 2014, 2015 dhe 2016, subjekti ka pasur 795 çështje, nga të cilat, 790 çështje të përfunduara dhe 5 të mbartura në vitin e fundit.

30. Tri dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit

31. Dokumenti nr. 1 – konkluzione të çështjes për procedimin penal nr. ***, viti 2010

Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar para Gjykatës së Apelit Korçë prishjen e vendimit nr. ***, datë 28.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të disa akteve procedurale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pushimin e procedimit penal. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 16.1.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me një tjetër trup gjykues.

32. Dokumenti nr. 2 – konkluzione të çështjes për procedimin penal nr. ***, viti 2012

Me vendimin nr. ***, datë 10.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur deklarinin fajtor dhe dënimin me nga 2 vjet burgim të tre të pandehurve për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit, në bashkëpunim”, si dhe deklarinin e pafajshëm të një të pandehuri tjetër. Në konkluzionet e saj, subjekti i rivlerësimit kërkon para Gjykatës së Apelit Korçë ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, deklarinin fajtor të katër të pandehurve dhe dënimin e tre prej tyre me nga 6 vjet burgim dhe tjetrit me 10 vjet burgim. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 21.1.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, deklarinin fajtor të katër

të mira komunikimi dhe ka sjellje të mirë, ka aftësi bashkëpunimi dhe pune në grup, si dhe është angazhuar në një sërë aktivitete profesionale.

³Sipas formularit të vetëvlerësimit profesional (shtojca 4).

të pandehurve dhe dënimin me 5 vjet burgim për dy prej tyre dhe 6 vjet burgim për dy të pandehurit e tjerë.

33. Dokumenti nr. 3 – konkluzione të çështjes për procedimin penal nr. ***, viti 2015

Me vendimin nr. ***, datë 2.4.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur: Pranimin e kërkesës së të pandehurit Gj. Gj. për shuarjen e masës së sigurimit “arrest me burg” dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore”. Pas ankimit të çështjes, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përpara Gjykatës së Apelit Korçë ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe rrëzimin e kërkesës së të pandehurit Gj. Gj.. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 15.4.2016, ka vendosur sipas kërimit të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion: në tri dokumentet e paraqitura për vlerësim nga vetë subjekti, edhe pas analizës së kryer nga ana e vetë Komisionit, nuk janë konstatuar problematika që të mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit në lidhje me kriterin profesional.

B/2. PESË DOSJET E PËRZGJEDHURA ME SHORT SIPAS NJË SISTEMI RASTËSOR DHE OBJEKTIV

34. Dosja nr. 1 – konkluzion për çështjen që i përket procedimit penal nr. ***, datë 15.12.2013, në ngarkim të shtetasit E. Xh. për veprën penale “shkatërrim i veprave kulturore”

34.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka kërkuar në gjykatë deklarimin fajtor të shtetasit E. Xh. dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 18.7.2014, ka vendosur deklarimin fajtor dhe dënimin e tij me 300,000 lekë gjobë. Ky vendim është ankimuar nga prokurori i çështjes.

34.2 Gjatë gjykimit në shkallë të dytë, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar prishjen e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 18.7.2014 dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë me tjetër trup gjykues. Me vendimin nr. ***, datë 28.1.2015, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur pranimin e kërkesës së subjektit.

35. Dosja nr. 2 – konkluzion për çështjen që i përket procedimit penal nr. ***, datë 12.12.2013, në ngarkim të të pandehurit A. D. për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen” (nenet 273 dhe 290/3 të Kodit Penal)

35.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka kërkuar në Gjykatë deklarimin fajtor të shtetasit A. D. dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim, si dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin me 4 vjet burgim. Gjykata vendosi⁴ deklarimin fajtor të këtij shtetasi, dënimin e tij me 5 vjet e 6 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e tij me 3 vjet e 8 muaj burgim. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet e saj datë 12.11.2014 para Gjykatës së Apelit Korçë, ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe

⁴Me vendimin nr. ***, datë 5.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur⁵ pranimin e kërkesës së subjektit duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

36. Dosja nr. 3 – konkluzion për çështjen që i përket procedimit penal nr. ***, viti 2014, për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “dhunim i banesës”

36.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin datë 28.1.2014 ka vendosur mosfillimin e këtij procedimi. Mbi bazën e ankimit të kallëzuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi⁶ prishjen e vendimit të prokurorisë dhe detyrimin e saj të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetime. Pasi prokuroria kreu hetime të plota, në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata, por edhe nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Korçë, vendosi⁷ pushimin e procedimit penal.

36.2 Pas ankimit të kallëzuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 22.1.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të prokurorisë. Kallëzuesi bëri ankim ndaj vendimit gjyqësor dhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Korçë subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në konkluzionet e saj, datë 11.5.2016, lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 22.1.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me arsyetimin se çështja duhet të zgjidhet në rrugë civile. Gjykata e Apelit Korçë⁸ ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 22.1.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

37. Dosja nr. 4 – konkluzion për çështjen që i përket procedimit penal nr. ***, viti 2010, në ngarkim të shtetasit M. K. për veprën penale “vrasje me paramendim” e mbetur në tentativë

37.1 Me vendimin nr. ***, datë 28.7.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur masën e sigurimit personal “arrest në burg” ndaj shtetasit M. K. në mungesë. Kjo masë u ekzekutua në datën 21.6.2014, kur ky shtetas u arrestua në pikën kufitare, Kapshticë.

37.2 Kjo gjykatë, me vendimin datë 23.6.2014, ka konfirmuar vazhdimësinë e kësaj mase arresti, pasi prokurori ka kërkuar që ajo të qëndrojë në fuqi derisa të mbarojë gjykimin në Gjykatën e Apelit. Kundër këtij vendimi shtetasi M. K. ka paraqitur ankim përpara Gjykatës së Apelit Korçë, duke pretenduar se: (i) ishte dënuar në shtetin grek për këtë vepër me vendimin datë 24.1.2014, të gjykatës greke dhe si rrjedhojë s’mund të dënohej dy herë për të njëjtën vepër; (ii) në bazë të nenit 228/2 të Kodit të Procedurës Penale ekzistonin shkaqe padënueshmërie për sa kohë që shteti grek me vendimin nr. ***, datë 23.9.2013, ka refuzuar ekstradimin e tij në Shqipëri dhe ka shfuqizuar urdhërarrestin ndërkombëtar të dhënë nga shteti shqiptar.

37.3 Shtetasi M. K pretendon se gjatë gjykimit ka depozituar fletën e daljes nga burgu grek dhe vendimin e gjykatës greke për dënimin e tij, të përkthyer dhe noteruar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë citon në procesverbalin e seancës gjyqësore se këto prova nuk janë në formën e kërkuar nga ligji (as të përkthyer e as të legalizuara).

⁵Me vendimin nr. ***, datë 12.11.2014, të Gjykatës së Apelit Korçë.

⁶Me vendimin nr. ***, datë 14.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁷Me vendimin datë 24.11.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁸Me vendimin nr. ***, datë 11.5.2016, të Gjykatës së Apelit Korçë.

37.4 Subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 28.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi pretendimet e të dyshuarit kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe nga aktet e paraqitura rezulton se nuk ndodhet para një vendimi penal, që ka marrë formë të prerë në shtetin grek dhe, si rrjedhojë, nuk pengon vazhdimin e ndjekjes penale në Republikën e Shqipërisë. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ***, datë 17.7.2014, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 28.7.2011, sipas kërimit të subjektit.

38. Dosja nr. 5 – konkluzion për çështjen që i përket procedimit penal nr. ***, viti 2011, për veprën penale “plagosje e rëndë me dashje” në bashkëpunim

38.1 Në datën 25.7.2011 është regjistruar procedimi penal në ngarkim të shtetasve M. D., E. D. dhe B. D., të cilët akuzohen se pas një grindjeje për motive të dobëta në lokal me shtetasin P. Z., e kanë ndjekur këtë në shtëpinë e tij dhe aty e kanë rrahur. Ka ndërhyrë shtetasi A. Z., babai i P. për ta mbrojtur të birin, por është goditur nga të pandehurit M. D. dhe E. D. dhe, si pasojë, ka gjetur vdekjen, ndërkohë që i pandehuri tjetër B. D. ka qëndruar jashtë banesës dhe nuk ka kallëzuar krimin e kryer.

38.2 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, bazuar në nenet 88/2 dhe 25 të Kodit Penal, ka dërguar çështjen për gjykim dhe, në përfundim të gjykimit, ka kërkuar deklarinin fajtor të shtetasve M. D. dhe E. D. për veprën penale “plagosje e rëndë me dashje me pasojë vdekjen” dhe dënimin e tyre respektivisht, me 6 vjet burgim dhe 7 vjet, si dhe deklarinin fajtor të shtetasit B. D. për veprën penale “moskallëzim krimi” dhe dënimin me 1 vit burg.

38.3 Me vendimin nr. ***, datë 3.4.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur deklarinin e pafajshëm të tre të pandehurve me arsyetimin se nuk provohet që veprat penale të jenë kryer nga të pandehurit. Prokuroria e Rrethit Korçë ka bërë ankim ndaj këtij vendimi, duke kërkuar prishjen e tij dhe që gjykata të vendosë sipas kërtimeve të prokurorisë.

38.4 Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Korçë, prokurorja e Prokurorisë së Apelit Korçë, znj. R. Q., i ka kërkuar gjykatës të thërrasë për të ripyetur ekspertin mjekoligjor. Gjykata e Apelit, me vendim të ndërmjetëm, e ka refuzuar kërkesën e Prokurorisë.

38.5 Me vendimin nr. ***, datë 4.9.2012, Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 3.4.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, subjekti i rivlerësimit ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe rikthimin e çështjes pranë të njëjtës gjykatë për gjykim me tjetër trup gjykues.

38.6 Me vendimin nr. ***, datë 29.10.2014, Gjykata e Lartë ka vendosur të pranojë rekursin e subjektit të rivlerësimit.

38.7 Gjatë rigjykimit, Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për ripyetjen e ekspertëve mjeko-ligjorë dhe atij kriminalist.

38.8 Në përfundim të rigjykimit të çështjes, pasi subjekti i rivlerësimit ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 3.4.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë,

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ***, datë 6.4.2016, ka vendosur: (i) ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 3.4.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; (ii) deklarinim fajtor të 2 të pandehurve M. D. dhe E. D. për veprën penale “plagosje e rëndë nga pakujdesia” (neni 91 i Kodit Penal) dhe dënimin e tyre me nga 1 vit burgim, si dhe deklarinim fajtor të të pandehurit B. D. për veprën penale “moskallëzim krimi” dhe dënimin e tij me 8 muaj burgim.

38.9 Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs subjekti i rivlerësimit duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 6.4.2016, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe rikthimin e çështjes për gjykim në Gjykatën e Apelit Korçë, me argumentin se kjo gjykatë nuk ka marrë në shqyrtim pasojën e veprimeve të të pandehurve që është vdekja e viktimës dhe ka ndryshuar kështu kualifikimin juridik të veprës duke lehtësuar pozitën e të pandehurve.

38.10 Sipas shkresës nr. *** prot., datë 9.1.2018, të Gjykatës së Lartë, çështja është në pritje për t’u gjykuar pranë kësaj gjykate. Edhe në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Gjykata e Lartë konfirmon⁹ se kjo çështje ndodhet në pritje për gjykim.

Në lidhje me pesë dosjet më lart, Komisioni konstatoi problematika në lidhje me veprimet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit

B/3 TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

39. Nga verifikimi i të dhënave nga arkiva e Prokurorisë së Përgjithshme¹⁰ dhe përgjigjet e prokurorive të rretheve gjyqësore¹¹, dërguar pranë kësaj prokurorie, ka rezultuar se nuk ka: të dhëna për procedim disiplinor; të dhëna nga agjencitë ligjzbatuese për veprime që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit; të dhëna për kontakte të subjektit me persona të papërshtatshëm; kopje të fashikujve të procedimeve penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara, ku përmendet subjekti i rivlerësimit; ankesa në vitet 2006 – 2018.

40. Në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme janë arkivuar vlerësimet “shumë mirë” për subjektin gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 nga Prokurori i Përgjithshëm.

41. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë konfirmon¹² se pranë saj nuk është regjistruar procedim penal ndaj subjektit të rivlerësimit.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2022, e Gjykatës së Lartë.

¹⁰Shkresat nr. *** prot., datë 23.2.2018, nr. *** prot., datë 5.4.2018 dhe nr. *** prot., datë 5.3.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme.

¹¹Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec me përgjigjet: nr. *** prot., datë 14.2.2018; Sarandë nr. *** prot., datë 16.2.2018; Shkodër nr. *** prot., datë 19.2.2018; Lushnjë nr. *** prot., datë 12.202018; Mat nr. *** prot., datë 20.2.2018; Elbasan nr. *** prot., datë 22.2.2018; Fier nr. *** prot., datë 16.2.2018; Tiranë nr. *** prot., datë 6.3.2018; Krujë nr. *** prot., datë 22.2.2018; Durrës nr. *** prot., datë 21.202018; Gjirokastër nr. *** prot., datë 19.2.2018; Korçë nr. *** prot., datë 22.2.2018; Pukë nr. *** prot., datë 13.2.2018; Dibër nr. *** prot., datë 13.2.2018; Tropojë nr. *** prot., datë 19.2.2018; Kavajë nr. *** prot., datë 14.2.2018; Kurbin nr. *** prot., datë 22.2.2018; Përmet nr. *** prot., datë 25.2.2018; Kukës nr. *** prot., datë 16.2.2018; Berat nr. *** prot., datë 13.2.2018; Lezhë nr. *** prot., datë 26.2.2018; Vlorë nr. *** prot., datë 19.2.2018.

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 7.3.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

DENONCIME

42. Denoncimi nr. * prot., datë 14.2.2019, nga shtetasi A. Gj.,** i cili pretendon se për veprën penale të vrasjes së shtetasit A. Gj. në datën 5.8.1997 nga disa persona, subjekti i rivlerësimit, në bashkëpunim me autorin e veprës penale, e ka mbuluar çështjen hap pas hapi, e ka zvarritur çështjen deri në skadencën e afateve dhe e pushoi me vendimin nr. ***, datë 25.8.2000, si dhe ka kryer veprime hetimore në kundërshtim me ligjin.

43. Denoncimi nr. * prot., datë 17.10.2018, nga shtetasit M. dhe A. D.,** të cilët pretendojnë se në lidhje me pronësinë e banesës së tyre kanë një konflikt ende të pazgjidhur dhe, për këtë, fajësojnë dhe ankohen ndaj disa funksionarëve shtetërorë (punonjës të ASHK Korçë, noterë, inspektorë të Bashkisë Korçë, prokurorë dhe gjyqtarë) për falsifikime dhe veprime të tjera të padrejta. Denoncuesit akuzojnë subjektin e rivlerësimit se mbron vendimet e padrejta të kolegëve të saj prokurorë e gjyqtarë.

Në lidhje me këto dy denoncime, Komisioni konstaton se ato trajtojnë çështje që janë jashtë afatit ligjor, referuar nenit 41, pikave 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit vlerësimi profesional i subjektit nuk mund të shtrihet përpara muajit janar 2006. Për rrjedhojë, pavarësisht hetimit të kryer, Komisioni nuk mund t'i mbajë ato në konsideratë në lidhje me konkluzionet mbi vlerësimin profesional për subjektin e rivlerësimit.

KONSTATIME TË TJERA

44. Marrë në konsideratë informacione të organeve ligjzbatuese, Komisioni ka administruar dhe shqyrtuar dosjen e procedimit penal nr. ***, viti 2010 dhe fashikujt gjyqësorë të këtij procedimi¹³, ku vëren se në datën 1.11.2010 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “dhunim i varreve” dhe pas hetimeve çështja është dërguar për gjykim¹⁴.

44.1 Prokurorja e çështjes (znj. I. Ç.) ka kërkuar në gjykatë: dënimin e të pandehurit N. D. me 2 vjet burgim për veprën penale “ndërtim i paligjshëm në bashkëpunim”, 1 vit për veprën “dhunim varresh” në bashkëpunim dhe në bashkim të dënimeve dënimin me 2 vjet burgim; dënimin e të pandehurit A. K. me 1 vit burgim për “ndërtim të paligjshëm” në bashkëpunim, 6 muaj burgim për “dhunim varresh” në bashkëpunim dhe në bashkim të dënimeve ka kërkuar dënimin me 1 vit burgim dhe pezullimin e dënimit me burgim, duke e vënë në provë për 3 vjet; dënimin e të pandehurit L. Z. me 1 vit burgim për “ndërtim të paligjshëm” në bashkëpunim, 6 muaj burgim për “dhunim varresh” në bashkëpunim, në bashkim të dënimeve ka kërkuar dënimin me 1 vit dhe pezullimin e dënimit me burgim e vënien në provë për 3 vjet.

¹³Me shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

¹⁴Sipas vendimit datë 24.11.2010 për dërgimin e çështjes në gjyq dhe kërkesës datë 24.11.2010 për gjykimin e çështjes së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

44.2 Pas disa proceseve gjyqësore, të tre të pandehurit janë shpallur të pafajshëm nga Gjykata e Apelit Korçë dhe Gjykata e Lartë nuk ka pranuar rekursin e Prokurorisë së Apelit Korçë¹⁵.

44.3 Rezulton se gjatë gjykimit të kësaj çështjeje penale subjekti i rivlerësimit Irma Balli nuk ka përfaqësuar asnjëherë këtë çështje para Gjykatës së Apelit apo të ketë bërë recurs në Gjykatën e Lartë, por ka qenë në detyrën e Drejtueses së Prokurorisë së Apelit Korçë. Pika II/3 e urdhrit nr. ***, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm përcakton se: *“Drejtuesit e Prokurorive të Apeleve... ushtrojnë funksione organizimi, drejtimi dhe kontrolli në gjykimin e çështjeve të apeluara, përkatësisht në Prokuroritë e Apeleve ku janë caktuar, si dhe funksione të përcaktuara në Kushtetutë e në ligj...”*. Nga hetimi nuk rezulton asnjë akt në lidhje me qëndrimin e subjektit si Drejtuese e Prokurorisë së Apelit Korçë në lidhje me këtë rast.

44.4 Për sa më lart, duket se gjatë rigjyimit në Gjykatën e Apelit Korçë prokurorja e Prokurorisë së Apelit Korçë ka kërkuar pezullimin e dënimit për të pandehurin N. D., pa provuar ekzistencën e ndonjë prej kritereve të përcaktuara nga neni 59 i Kodit Penal, si dhe duke vepruar në kundërshtim me rekursin e bërë prej saj ndaj vendimit nr. ***, datë 10.1.2012, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe me ankimin e prokurorisë së shkallës së parë ndaj vendimit nr. ***, datë 9.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, akte procedurale këto ku nuk është kundërshtuar dënimi i të pandehurit me 1 vit burgim për veprën penale “dhunim i varreve”.

¹⁵Me vendimin nr.***, datë 9.6.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur: (1) deklarinim “të pafajshëm” të 3 të pandehurve për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”; (2) deklarinim fajtor të të pandehurve N. D., A. K. dhe L. Z. për veprën penale “dhunim varresh” në bashkëpunim dhe dënimin e tyre respektivisht me 1 vit burgim, me 6 muaj burgim dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit duke e vënë në provë për 18 muaj që të mos kryejë vepër tjetër penale, me 6 muaj dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit duke e vënë në provë për 18 muaj që të mos kryejë vepër tjetër penale. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka ankimuar vendimin gjyqësor duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe dënimin e tre të pandehurve për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”. Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Korçë, prokurorja e Apelit (znj. R. Q.) ka kërkuar kryerjen e ekspertimit teknik për të konkluduar saktë kategorinë e punimeve të kryera nga të pandehurit dhe nëse për këto punime kërkohej apo jo leje sipas ligjit për urbanistikën. Gjykata e Apelit ka refuzuar kërkesën e saj dhe me vendimin nr. ***, datë 10.1.2012, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Prokuroria e Apelit Korçë ka bërë recurs ndaj vendimit nr. ***, datë 10.1.2012, të Gjykatës së Apelit Korçë, duke kërkuar prishjen e tij dhe kthimin e akteve për rigjykim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues. Me vendimin nr. ***, datë 17.10.2012, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 10.1.2012, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe rikthimin e çështjes për gjykim pranë kësaj gjykate duke lënë detyrat përkatëse. Gjatë rigjyimit në Apel, sipas aktekspertizës datë 26.3.2013, ekspertja ka konkluduar se ndërtimi i rrugicës me gjerësi 1.3 m brenda territorit të kishës nuk konsiderohet si rrugë nga ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 dhe VKM-ja Nr. 722, datë 19.11.1998 “Rregullorja e urbanistikës”, por si punime sistemimi të brendshëm dhe për këto punime nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi. Në përfundim të gjykimit në Apel, prokurorja R. Q. ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 9.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, por me ndryshimin që për të pandehurin N. D. të pezullohet ekzekutimi i dënimit 1 vit për veprën penale “dhunim varresh” në bashkëpunim, për një afat prove 18 muaj që të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. Për këtë ndryshim, në dënimin e të pandehurit N. D., prokurorja e çështjes nuk ka sjellë asnjë argument shtesë duke lehtësuar kështu dënimin e tij. Në përfundim të rigjyimit, me vendimin nr. ***, datë 15.5.2013, Gjykata e Apelit Korçë u ka dhënë pafajësi të tre të pandehurve për veprat penale “ndërtim i paligjshëm” dhe “dhunim i varreve”. Në datën 12.6.2013, Prokuroria e Apelit Korçë ka bërë recurs kundër vendimit nr. ***, datë 15.5.2013, të Gjykatës së Apelit Korçë. Me vendimin nr. ***, datë 4.12.2014, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit.

44.5 Për këto veprime, Komisioni ka ngritur dyshime për favorizim të të pandehurit N. D.

44.6 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë shpjegime në lidhje me qëndrimin e saj si drejtuese e Prokurorisë së Apelit Korçë për veprimet dhe qëndrimin që prokurorja e çështjes në fjalë ka mbajtur përpara gjykatës në lidhje me këtë gjykim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

44.7 Në prapësime, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se prokurorja e çështjes e ka ngritur këtë kërkesë mbi bazën e parimit të pavarësisë në seancë gjyqësore, ashtu siç e ka vlerësuar vetë ajo në pavarësi të plotë, referuar nenit 25 të Kodit të Procedurës Penale dhe se ajo nuk ka pasur dijeni mbi qëndrimin e prokurores gjatë gjykimit të çështjes përkatëse në Gjykatën e Apelit Korçë.

44.8 Subjekti sqaron se Prokuroria e Apelit Korçë që ajo drejton, ka bërë rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë që ka dhënë pafajësi për tre të pandehurit duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

44.9 Subjekti sqaron se kjo dosje është kërkuar dy herë nga Prokuroria e Përgjithshme në vitet 2012 dhe 2013 pas përfundimit të gjykimit, por nga kjo prokurori nuk ka ardhur asnjë konsideratë në lidhje me qëndrimin apo sjelljen e prokurores së seancës apo vetë subjektit.

44.10 Në vijim të shpjegimeve të dhëna, subjekti sqaron se ajo nuk është intimiduar si individ apo si institucion gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes, madje rekursi i bërë nga kjo prokurori në përputhje me ligjin e rëndonte pozitën e të pandehurit. Gjithashtu, subjekti ka qartësuar se nuk ka ushtruar ndikim tek prokurori i çështjes apo tek gjyqtarët dhe nuk ka favorizuar të pandehurit qoftë si subjekt, qoftë si institucion.

Vlerësimi i Komisionit

44.11 Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe provat bashkëlidhur, i vlerëson ato të mjaftueshme, duke mos konstatuar pjesëmarrje të subjektit të rivlerësimit në rolin e prokurorit të çështjes, në proceset gjyqësore të zhvilluara në lidhje me këtë procedim penal, si dhe një qasje të pranueshme të subjektit në këtë proces gjyqësor, në rolin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë.

44.12 Nga përmbajtja e akteve të administruara nga Komisioni dhe atyre të depozituara nga subjekti, duket se qëndron edhe pretendimi i subjektit se nga Prokuroria e Apelit Korçë janë bërë të gjitha përpjekjet ligjore për dënimin e të pandehurve në bazë të provave, duke zbatuar të gjitha mundësitë procedurale nëpërmjet rekurseve.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se në veprimet e subjektit të rivlerësimit nuk konstatohen mangësi që mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi në aspektin e vlerësimit profesional.

45. Gjatë hetimeve të kryera, Komisioni ka verifikuar fashikullin e procedimit penal nr. ***, për të cilin subjekti i rivlerësimit Irma Balli ka përfaqësuar Prokurorinë e Apelit

gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit, si dhe ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të kësaj gjykate.

45.1 Në lidhje me këtë procedim në ngarkim të shtetasit A. F. për veprën penale “vrasje me dashje” të një personi të mitur dhe “kanosje”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 4.2.2016, ka vendosur shpalljen fajtor për veprën penale “vrasje me dashje” dhe dënimin e të pandehurit me 9 vjet burgim, si dhe për veprën penale “kanosje” dhe dënimin me 6 muaj burgim. Të njëjtin cilësim të veprës penale “vrasje me dashje” ka bërë edhe prokurorja e çështjes në Prokurorinë e Rrethit Korçë. Në aplikim të gjykimit të shkurtuar pas bashkimit të dënimeve, ky i pandehur është dënuar nga gjykata me 6 vjet burgim, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 15.2.2016 dhe për të cilin drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë ka firmosur edhe një urdhërezekutimi nr. ***, datë 16.2.2016.

45.2 Ndaj vendimit nr. ***, datë 4.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është bërë një ankim më vonë, jo nga prokurorja e çështjes, por nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Korçë, duke kërkuar ndryshimin e cilësimit të veprës nga “vrasje me dashje” në “vrasje në rrethana cilësuese” (sipas ankimit nga drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Korçë), ankim ky i regjistruar me numër me fraksion. Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit, subjekti ka kërkuar vazhdimin e gjykimit duke mbështetur ankimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.

45.3 Me vendimin nr. ***, datë 10.11.2016, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur mospranimin e këtij ankimi si jashtë afatit duke parashtruar dhe argumentuar faktet për këtë mospranim ankimi. Ndaj këtij vendimi, subjekti ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Korçë.

45.4 Në analizë të rrethanave si më lart, Komisioni vëren se në veprimet e subjektit të rivlerësimit me cilësinë e prokurores së çështjes pranë Gjykatës së Apelit, nuk konstatohen mangësi që ngarkojnë me përgjegjësi subjektin.

45.5 Në lidhje me funksionin e subjektit si drejtuese e Prokurorisë së Apelit, Komisioni vëren se subjekti nuk ka informuar Drejtorinë Gjyqësore në zbatim të pikës 10.1/e të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm që përcakton: *“Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit duhet të informojë me shkrim Drejtorinë Gjyqësore, duke parashtruar arsyet përkatëse, kur konstaton qëndrime të gabuara në ushtrimin e të drejtës së ankimit nga prokurorët më të ulët”*, kjo për shkak të bërjes së ankimit nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë kishte marrë formë të prerë dhe ndryshimi i kualifikimit të veprës penale nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Korçë nga ai i prokurores së rrethit, që përfaqësonte akuzën gjatë gjykimit në shkallë të parë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

45.6 Subjekti, në prapësimet e saj ka shpjeguar se Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 7.7.2022, ka pranuar rekursin e ushtruar nga subjekti ndaj vendimit nr. ***, datë 10.11.2016, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe ka kthyer çështjen për rigjykim. Në këtë vendim, Gjykata e Lartë ka evidentuar dy çështje: (i) nuk ka vendim të formës së

prerë dhe ankimi është ushtruar sipas rregullave dhe afateve ligjore; (ii) gjykata e rigjykimit duhet të hetojë pretendimet e prokurorisë të parashtruara në Apel.

45.7 Subjekti ka depozituar në Komision vendimin nr. ***, datë 7.7.2022, të Gjykatës së Lartë.

Vlerësimi i Komisionit

45.8 Komisioni, pasi mori në konsideratë prapësimet e subjektit dhe vendimin nr. ***, datë 7.7.2022, të Gjykatës së Lartë, vëren se kjo gjykatë ka prishur vendimin nr. ***, datë 10.11.2016, të Gjykatës së Apelit dhe ka kthyer çështjen për rigjykim pranë kësaj gjykate. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Lartë thekson se ka konstatuar që ankimi i Prokurorisë së Rrethit Korçë është bërë sipas formës e afatit të përcaktuar nga nenet 412 dhe 415 të Kodit të Procedurës Penale dhe përmban shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe Gjykata e Apelit duhet të shqyrtojë në themel pretendimet e prokurorisë të parashtruara në apelin e depozituar në datën 12.2.2016.

Për sa më lart, në kushtet kur vendimi i Gjykatës së Apelit në lidhje me paraqitjen e ankimit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë është vlerësuar nga një gjykatë më e lartë, e cila i ka gjetur të drejtë afatin, formën dhe shkaqet e ankimit, prapësimet e subjektit vlerësohen bindëse për Komisionin, i cili arrin në përfundimin se në veprimet e subjektit, në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë së Apelit Korçë, dhe në raport me veprimet e prokurorëve më të ulët (të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë), nuk ka mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi në lidhje me aftësitë profesionale.

VLERËSIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT NË CILËSINË E DREJTUESES SË PROKURORISË SË APELIT KORÇË

46. Me qëllim vlerësimin e aftësive të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë së Apelit Korçë, sipas kompetencave të drejtuesit të përcaktuara në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (ligji në fuqi gjatë periudhës që subjekti ka qenë në detyrën e drejtueses së prokurorisë), në nenet 42, 43, 46, etj. të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 80, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i ka kërkuar subjektit me *email*, datë 10.4.2022, disa akte, të cilat pasqyrojnë veprimet e saj në zbatim të këtyre kompetencave, konkretisht:

- i. akte vendimmarrëse nga ana e saj në pozicionin e drejtueses së Prokurorisë së Apelit Korçë për ndarjen e prokurorëve në seksione;
- ii. lëvizjet e prokurorëve nëpër sektorë të ndryshëm dhe arsyen përkatëse;
- iii. akte vendimmarrëse apo urdhra për planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrave urgjente;
- iv. praktikat e plota të zëvendësimit të prokurorëve që kanë pasur pengesa në proces, shoqëruar me fletën përkatëse të regjistrit të çështjeve dhe të librit të protokollit;

- v. rastet e heqjeve dorë nga ankimi përpara Gjykatës së Apelit Korçë, shoqëruar me dokumentin përkatës të prokurorit dhe miratimin e drejtuesit të prokurorisë, shoqëruar me fletën përkatëse të regjistrit të çështjeve dhe të librit të protokollit;
- vi. rastet e moskryerjes së rekursit duke bashkëlidhur vendimin përkatës të Gjykatës së Apelit, memon apo relacionin e prokurorit përkatës dhe miratimin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit, shoqëruar me fletën përkatëse të regjistrit të çështjeve dhe të librit të protokollit.

47. Komisioni, pasi mori në shqyrtim shpjegimet dhe aktet e dërguara nga subjekti, vëren se:

48. *Në lidhje me aktet sipas pikave i dhe ii më lart*, subjekti shpjegon se Prokuroria e Apelit Korçë, për periudhën e kërkuar e në vazhdim, ka funksionuar vetëm me dy prokurorë sipas organikës së miratuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe në asnjë rast nuk ka pasur ndarje në seksione.

49. *Në lidhje me aktet sipas pikës iii më lart*, subjekti shpjegon se në asnjë rast nuk ka akte vendimmarrëse apo urdhra për planifikimin e prokurorëve të apelit për çështje me natyrë urgjente.

50. *Në lidhje me aktet sipas pikës iv më lart*, subjekti shpjegon se në asnjë rast nuk ka pasur kërkesë prej prokurorit apo palëve në proces për zëvendësimin e prokurorit në një çështje, sipas dispozitave procedurale, nenet 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale.

51. *Në lidhje me aktet sipas pikës v më lart*, subjekti shpjegon se rastet e heqjes dorë nga apeli (ankimi) i ushtruar nga prokurori i rrethit gjyqësor, janë paraprirë nga një relacion apo informacion nga prokurori që i janë bashkëngjitur këtij informacioni me materialin e kërkuar.

52. *Në lidhje me aktet sipas pikës vi më lart*, subjekti shpjegon se rastet e mosushtrimit të rekursit lidhen me rastet kur vendimi i Gjykatës së Apelit nuk është marrë në kundërshtim me kërkesat e nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale dhe subjekti është informuar me informacion nga prokurori i çështjes për mosushtrimin e rekursit. Rastet e tilla janë bashkëlidhur materialit.

53. Në vijim, subjekti shpjegon se për periudhën për të cilën kërkohen të dhëna nuk ka pasur regjistër të qarkullimit të brendshëm të dokumentacionit me numër protokollit (ky regjistër është krijuar vetëm në vitin 2020 mbi udhëzimin nr. ***, datë 20.7.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm). Ky moment zgjidhej në këtë formë: informacioni apo relacioni për heqjen dorë nga ankimi apo mosushtrimi i rekursit dorëzohet tek titullari i institucionit dhe më pas një kopje mbahej në kryesekretari dhe vendosej në dosjen e informacioneve dhe relacioneve, ndërsa kopja tjetër e sigluar nga drejtuesi i institucionit me miratim ose jo, vendosej në dosjen përkatëse që ruhet në arkivin e institucionit.

54. Komisioni mori në shqyrtim dokumentacionin e dërguar nga subjekti dhe vëren se ka paraqitur: fletën përkatëse të regjistrit të çështjeve për secilin vit 2014 – 2016, me të dhënat përkatëse identifikuese, si numrin rendor, të dhënat e çështjes (numër e datë

vendimi të gjykatës së rrethit apo të apelit, lloji i çështjes, baza ligjore e çështjes, emri i prokurorit që ka ndjekur çështjen, cilësia e personit ndaj të cilit është ngritur çështja penale); disa çështje të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit nga këta regjistra, si raste të heqjes dorë nga ankimi dhe raste të mosushtrimit të rekursit për vitet 2014, 2015 dhe 2016. Rastet e përzgjedhura trajtohen si sipas viteve 2004, 2005 dhe 2006.

55. Për vitin 2014 subjekti ka përzgjedhur 7 çështje që i ka dërguar Komisionit për shqyrtim, për vitin 2015 ka përzgjedhur 15 raste dhe për vitin 2016 ka përzgjedhur 6 raste.

56. Nëpërmjet prapësimeve, në lidhje me çështjet e hetuara në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë së Apelit Korçë si më lart, subjekti ka dhënë shpjegime përmbledhëse duke shpjeguar se gjatë ushtrimit të kësaj detyre është bazuar në nenin 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që ka qenë në fuqi për periudhën e rivlerësimit *Vetting*, në ligjin procedural penal, akte këto që përcaktojnë centralizimin e prokurorisë dhe pavarësinë e prokurorëve. Gjithashtu, subjekti është bazuar edhe në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, sidomos në udhëzimin nr. ***, datë 14.11.2008, duke mbajtur kontakt të vazhdueshëm me Drejtorinë e Gjyqësorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Komunikimi me këtë drejtori ka qenë me shkrim dhe verbal. U vendosën edhe disa standarde për momente të udhëzimit që praktikisht bëheshin të paaplikueshme, siç ishte autorizimi i prokurorit të seancës apo heqja dorë nga ankimi i prokurorit në një kohë të shkurtër, e lidhur kjo me afatet e gjykimit.

57. Çështjet trajtohen sipas problematikave në vijim:

1. Raste në lidhje me informimin e Drejtorisë Gjyqësore, kur subjekti miratonte dorëheqjen e prokurorit të Prokurorisë së Apelit nga apelimi (pika 10.1/b e udhëzimit nr. *, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm)**

1.a) Çështjet kur subjekti i rivlerësimit ka informuar Drejtorinë Gjyqësore në zbatim të pikave 10.1/b, 1.1/c dhe 1.1/d të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm

58. Çështja penale (viti 2014) në ngarkim të shtetasit A. S. për veprën penale “shkatërrim i pronës nga pakujdesia”. Me vendimin nr. ***, datë 3.10.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur deklarimin e pafajshëm të të pandehurit. Kundër vendimit ka ushtruar ankim prokurori i rrethit. Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Korçë, prokurori i Apelit i ka paraqitur subjektit: (i) dorëheqjen nga ankimi datë 16.4.2014 gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit, për shkak se apeli i prokurorit të rrethit nuk parashtrohet shkaqe ligjore për ndryshimin e vendimit gjyqësor; (ii) informacionin rreth çështjes dhe dorëheqjen e prokurorit të Apelit, të miratuara nga subjekti; (iii) informacionin¹⁶ e subjektit për këtë qëndrim, drejtuar Drejtorisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme.

¹⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2014, të Prokurorisë së Apelit Korçë.

59. Çështja penale (viti 2016) në ngarkim të shtetasit O. M. për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, duke dëmtuar matësin e energjisë elektrike në banesën e tij. Me vendimin nr. ***, datë 11.3.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit, dënimin me 8 muaj burgim në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe caktimin e kohës së provës 18 muaj në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal. Kundër vendimit ka bërë ankim prokurori i rrethit duke mospranuar aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal. Prokurorja e Apelit i ka paraqitur subjektit informacion me shkrim dhe deklaratën e heqjes dorë nga ankimi datë 16.6.2016, duke shpjeguar dhe argumentuar se ekzistojnë rrethanat për t’u aplikuar neni 59 i Kodit Penal. Subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurores së Apelit dhe ka informuar me shkrim Drejtorinë e Kontrollit të Hetimit, Ndjekjes Penale, Përfaqësimit në Gjykim dhe Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

60. Çështja penale (viti 2016) në ngarkim të shtetasit A. B. për veprën penale “falsifikim i vulave, stampave e formularëve” duke falsifikuar vulat e vëna në pasaportën e tij për hyrje - dalje në shtetin grek në 4 raste, kur sipas sistemit TIMS nuk rezulton që të ketë kaluar kufirin dhe sipas aktekspertimit rezultuan vula të falsifikuara. Me vendimin nr. ***, datë 8.1.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit, dënimin me 4 muaj burgim në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe caktimin e kohës së provës 18 muaj në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal. Kundër vendimit ka bërë ankim prokurori i rrethit duke mospranuar aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal. Prokurorja e Apelit i ka paraqitur subjektit informacion me shkrim dhe deklaratën e dorëheqjes nga ankimi datë 11.5.2016, duke shpjeguar dhe argumentuar se ekzistojnë rrethanat për t’u aplikuar neni 59 i Kodit Penal. Subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurores së Apelit dhe ka informuar me shkrim¹⁷ Drejtorinë e Kontrollit të Hetimit, Ndjekjes Penale, Përfaqësimit në Gjykim dhe Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

61. Çështja penale (viti 2015) në ngarkim të shtetasit K. G. për veprën penale “prodhim e mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”. Ndaj vendimit nr. ***, datë 10.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka vendosur deklarin të pafajshëm të shtetasit K. G., ka ushtruar ankim prokurori i rrethit duke kërkuar deklarin e të pandehurit fajtor dhe dënimin e tij. Prokurori i Apelit, duke pretenduar se vendimi nr. ***, datë 10.2.2014, nuk është rrjedhojë e një hetimi të plotë gjyqësor, ka kërkuar ripyetjen e ekspertit teknik balistik dhe kryerjen e ekspertimit teknik për shpërthimin e lëndës së dyshuar si lëndë plasëse. Pasi Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesat e prokurorit të Apelit, ka rezultuar se lënda që i është gjetur të pandehurit nuk është lëndë plasëse. Prokurori i Apelit i ka paraqitur subjektit relacionin për deklarin e heqjes dorë nga apeli dhe i ka bashkëlidhur dorëheqjen datë 21.9.2015, të cilat subjekti i ka miratuar dhe ka informuar me shkrim Drejtorinë Gjyqësore pranë

¹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 28.4.2016, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

Prokurorisë së Përgjithshme, duke zbatuar kështu detyrimin e përcaktuar nga pikat 1.1/c (i) dhe 10.1/b të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008.

Komisioni nuk konstatoi mangësi në lidhje me ushtrimin e detyrës nga ana e subjektit në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë.

*1.b) Çështjet kur subjekti i rivlerësimit nuk është në rastet e përcaktuara nga pikat 1.1 dhe 10.1/b të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të detyrimit për të informuar Drejtorinë Gjyqësore*

62. Çështja penale (viti 2015) në ngarkim të shtetasit G. P. për veprën penale “kultivim i lëndëve narkotike” pasi iu gjetën të mbjella dy rrënjë bime *cannabis sativa*. Deklarata datë 20.10.2015 e prokurorit të Apelit për heqjen dorë nga ankimi. Me vendimin nr. ***, datë 4.10.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur vlerësim të ligjshëm të arrestimit të të ndaluarit dhe ka caktuar masën e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Kundër vendimit ka ushtruar ankim prokurori i rrethit duke kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Prokurori i Apelit, pasi ka informuar me shkrim subjektin për çështjen duke sugjeruar mospërfaqësimin e apelit dhe shkaqet që sipas të cilit janë në përputhje me kërkesat e nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale për të qëndruar masa e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, i ka paraqitur edhe dorëheqjen nga ankimi datë 20.10.2015. Subjekti ka miratuar dorëheqjen e prokurorit të Apelit nga ankimi.

63. Çështja penale (viti 2015) në ngarkim të shtetasit K. K. për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike” në shumën 43.602 lekë. Me vendimin nr. ***, datë 10.3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi ka aplikuar edhe nenin 406/1 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur dënimin e të pandehurit me 30 ditë burgim. Prokurori i seancës, i cili kishte kërkuar 2 muaj burgim, e ankimoi këtë vendim duke argumentuar se gjykata e dënoi të pandehurin me gjysmën e dënimit që kërkoi prokurori, i pandehuri nuk e ka pranuar akuzën dhe nuk ka treguar pendim të thellë.

64. Prokurori i Apelit ka informuar me shkrim subjektin në datën 23.7.2015, ku ka shpjeguar se apeli i prokurorit të rrethit është formal dhe se ai nuk pasqyron argumente ligjore për cenimin e vendimit gjyqësor në lidhje me masën e dënimit. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës është në zbatim të drejtë të ligjit material e procedural. Për këto arsye, prokurori i Apelit ka paraqitur edhe deklaratën datë 24.7.2015 për dorëheqje nga ankimi dhe mospërfaqësimin e apelit të prokurorit të rrethit. Subjekti ka miratuar informacionin dhe dorëheqjen e prokurorit të Apelit.

65. Çështja penale (viti 2016) në ngarkim të shtetasve E. dhe E. M. për veprën penale “vjedhje” në bashkëpunim, për vjedhjen e një tubi plastik 2.6 m, në pronësi të një shoqërie që kryente punime në rrugë. Me vendimet nr. ***, datë 12.1.2016 dhe nr. ***, datë 12.1.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur vlerësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore” për të dy të arrestuarit.

66. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim prokurori i rrethit, duke kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Prokurorja e Apelit ka informuar me shkrim subjektin rreth çështjes dhe faktit që ankimi i prokurorit të rrethit nuk sjell asnjë

argument ligjor për rrezikshmërinë e veçantë të veprës penale dhe të autorëve, të cilët nuk kanë precedentë të mëparshëm, argumente këto që të përlligjin caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, si dhe ka paraqitur me shkrim dorëheqjen nga ankimi datë 4.2.2016. Subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurores dhe dorëheqjen e saj nga ankimi.

Komisioni nuk konstatoi mangësi në lidhje me qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë.

1.c) Çështje kur duket se subjekti ka mbajtur qëndrim indiferent në lidhje me dorëheqjen nga ankimi i paraqitur prej prokurorit të çështjes së shkallës së parë dhe prej drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit, si dhe nuk ka njoftuar për këtë dorëheqje Drejtorinë Gjyqësore

67. Çështja penale (viti 2015) në ngarkim të shtetasit E. Xh. për veprën penale “shkatërrim i veprave kulturore”. Gjatë gjykimit në shkallë të parë, prokurori i rrethit ka kërkuar për të pandehurin dënimin me 3 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit Penal dënimin me 2 vjet burgim. Me vendimin nr. ***, datë 16.4.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur dënimin me 300,000 lekë gjobë. Ky vendim është ankimuar nga prokurori i rrethit me arsyetimin se vepra e të pandehurit dhe vetë ai paraqiste rrezikshmëri të lartë.

67.1 Me shkresën nr. ***, datë 23.9.2015, në datën e zhvillimit të seancës pranë Gjykatës së Apelit Korçë, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Korçë i paraqet kësaj gjykate dorëheqjen nga ankimi pa paraqitur arsyet e heqjes dorë.

67.2 Në dosje nuk ka asnjë akt të subjektit në lidhje me qëndrimin e saj mbi këtë dorëheqje, si dhe nuk ka njoftuar Drejtorinë Gjyqësore për këtë rast.

67.3 Në prapësimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: vendimin nr. ***, datë 16.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor; ankimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor datë 22.4.2015; heqjen dorë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë datë 23.9.2015, nga ankimi kundër vendimit nr. ***, datë 16.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor; vendimin nr. ***, datë 23.9.2015, të Gjykatës së Apelit Korçë.

68. Çështja penale (viti 2015) në ngarkim të shtetasit Zh. T. për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”. Gjatë gjykimit të shkurtuar në shkallë të parë, prokurori i çështjes ka kërkuar dënimin e të pandehurës me 8 muaj burgim, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 14.1.2015, ka vendosur dënimin me shumën 300,000 lekë, duke arsyetuar midis të tjerash se e pandehura i ka normalizuar marrëdhëniet me të dëmtuarën, duke e shpërblyer me 3,000,000 lekë. Prokurori i rrethit ka paraqitur ankimin datë 23.1.2015, duke kërkuar dënimin me 8 muaj burgim.

68.1 Me shkresën datë 29.9.2015, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Korçë i drejton Gjykatës së Apelit Korçë heqjen dorë nga ankimi, duke parashtruar të njëjtat arsye që citon gjykata në vendimin nr. ***, datë 14.1.2015.

68.2 Në dosje nuk ka asnjë akt të subjektit në lidhje me qëndrimin e saj mbi këtë dorëheqje, si dhe nuk ka njoftuar Drejtorinë Gjyqësore për këtë rast.

68.3 Në prapësimet e saj, subjekti ka depozituar:

- vendimin nr. ***, datë 14.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;
- ankimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor datë 23.1.2015;
- heqjen dorë nga ankimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor datë 29.9.2015;
- aktmarrëveshjen për ndërmjetësim nr. ***, datë 27.11.2014, midis shtetasve Zh. T. dhe A. T., vendimin nr. ***, datë 1.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për pushimin e padisë me objekt “shpërblim dëmi” të ngritur nga paditësja A. T. ndaj shtetasës Zh. T.;
- vendimin nr. ***, datë 6.10.2015, të Gjykatës së Apelit Korçë, etj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

69. Pasi Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj ka shpjeguar se për këto çështje ka ushtruar apel Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe ka qenë kjo prokurori që ka hequr dorë nga apeli që ka ushtruar duke paraqitur aktin e dorëheqjes në sekretarinë e Gjykatës së Apelit (neni 418 i Kodit të Procedurës Penale) dhe më pas ato janë administruar në seancë. As drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit dhe as prokurori i çështjes së rrethit nuk e kanë informuar për këtë qëndrim në shkelje të pikës 9 të udhëzimit dhe subjekti është vënë në dijeni ditën e gjykimit nga relatori i çështjes, kur dorëheqja ishte dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës së Apelit.

70. Vendimet e gjykatës së apelit lidhur me masën e dënimit të vendosur janë të drejta ligjore sepse është respektuar neni 47 e vijues i Kodit Penal dhe parimi i individualizimit të dënimit.

71. Dorëheqja e prokurorit të rrethit nga apelimi, nuk i nënshtrohej miratimit apo refuzimit nga ana e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit. Subjekti nuk ka informuar Drejtorinë e Gjyqësorit në mbështetje të pikës 10 të udhëzimit sepse e drejta e ankimit nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Korçë apo nga prokurori i çështjes dhe heqja dorë nga ankimi është një e drejtë e njohur nga ligji procedural penal. Në këtë rast është drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor që ka shkelur udhëzimin duke mosnjofuar për qëndrimin e tij.

Vlerësimi i Komisionit

72. Komisioni, pasi mori në shqyrtim prapësimet e subjektit dhe provat bashkëlidhur, vëren se ato qëndrojnë si në drejtim të arsyeve përse subjekti ka hequr dorë nga ankimi, ashtu edhe në drejtim të arsyeve përse nuk kishte detyrim që të njoftonte Drejtorinë Gjyqësore për këto veprime të tij dhe të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Për të dyja çështjet më lart (E. Xh. dhe Zh. T.) shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse dhe Komisioni arrin në përfundimin se nuk rezultojnë mangësi në veprimet e subjektit në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë, të cilat mund të ngarkojnë atë me përgjegjësi.

1.ç) Çështje në lidhje me mosinformimin e Drejtorisë Gjyqësore, kur subjekti miratonte dorëheqjen e prokurorit të apelit nga apelimi (pika 10.1/b e udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, e Prokurorit të Përgjithshëm)

73. Çështja penale (viti 2014) në ngarkim të shtetasve E. F. dhe F. M. për veprën penale “vjedhje” në bashkëpunim e mbetur në tentativë, pasi kanë vjedhur një kabull elektrik të instaluar nën tokë dhe jashtë funksionit me qëllim shitje për skrap. Me vendimin nr. ***, datë 20.10.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur dënimin e tyre me 6 muaj burgim, në aplikim të nenit 406/1 të Kodit Penal, dënimin me 4 muaj burgim dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit duke urdhëruar kryerjen e 100 orëve punë për interes publik sipas nenit 63 të Kodit Penal. Prokurori i çështjes ka ushtruar ankim duke kërkuar mosaplikimin e nenit 63 të Kodit Penal. Prokurori i Apelit i ka paraqitur subjektit: (i) dorëheqjen nga ankimi datë 15.4.2014, që ka ushtruar prokurori i rrethit, për shkak se apeli i prokurorit të rrethit nuk parashtron shkaqe ligjore për ndryshimin e vendimit; (ii) informacionin rreth çështjes dhe dorëheqjes. Subjekti ka miratuar dorëheqjen nga ankimi. Në këto kushte është respektuar kështu pika 7.1 e udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, por në dosje nuk ka informacion të subjektit drejtuar Drejtorisë Gjyqësore për këtë dorëheqje.

Për sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka informuar Drejtorinë Gjyqësore duke moszbatuar kështu detyrimin e përcaktuar nga pikat 10.1/b dhe 1.1/a të udhëzimit nr. *, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm.**

74. Çështja penale (viti 2014) në ngarkim të shtetasit I. H. për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”. Me vendimin nr. ***, datë 7.11.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur dënimin e të pandehurit me 1 vit burgim dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit duke e vënë atë në provë për 18 muaj që të mos kryejë veprën tjetër penale. Prokurori i Rrethit Gjyqësor Korçë ka ankimuar vendimin duke kërkuar ndryshimin e tij dhe mosaplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.

74.1 Prokurori i Apelit Korçë ka informuar me shkrim subjektin se referuar rrethanave lehtësuese të kryerjes së veprës penale plotësohen kriteret për t’u aplikuar neni 59 i Kodit Penal, prandaj vendimi i gjykatës është i drejtë, ndërsa parashtrimet e prokurorit të seancës janë të pabazuara në ligj e prova. Për këto arsye, prokurori i Apelit i ka paraqitur subjektit dorëheqjen në datën 28.4.2015 nga ankimi duke zbatuar pikën 7.1 të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008. Subjekti ka miratuar informacionin dhe dorëheqjen e prokurorit të Apelit nga ankimi kundër vendimit gjyqësor, por në dosje nuk ka informacion të subjektit, drejtuar Drejtorisë Gjyqësore për miratimin e dorëheqjes nga ankimi.

Për sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka informuar Drejtorinë Gjyqësore, duke moszbatuar kështu detyrimin e përcaktuar nga pika 10.1/b e udhëzimit nr. *, datë 14.11.2008.**

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

74.2 Në lidhje me informimin e Drejtorisë Gjyqësore në rastet kur subjekti i rivlerësimit miratonte dorëheqjen e prokurorit të Apelit nga apelimi, subjekti shpjegoi se informimi bëhej përgjithësisht me telefon dhe më pas dërgohej një informacion

nëpërmjet të cilit bëhej prezent diskutimi dhe vendimi i marrë. Ndonjëherë informacioni i shkruar neglizhohej, duke pasur parasysh rëndësinë e vogël të rastit dhe faktin që trupa gjyqësore dhe koha e shqyrtimit të çështjes, në asnjë moment nuk kushtëzoheshin nga marrëdhëniet brenda institucionit të prokurorisë.

74.3 Në lidhje me sa më lart, për informimin me telefon të Drejtorisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, subjekti ka dhënë të njëjtat prapësime edhe në seancën dëgjimore, duke shpjeguar se është vepruar në këtë mënyrë pavarësisht se kishte një udhëzim të vitit 2008 të Prokurorit të Përgjithshëm që ishte i detyrueshëm për t'u zbatuar.

74.4 Për këtë, trupi gjykues, në seancë dëgjimore, i kërkoi subjektit shpjegime për aplikimin e një mënyrë njoftimi (me telefon), e cila nuk ishte parashikuar si e tillë në udhëzim.

74.5 Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se janë gjithsej 3 çështje kur duhej të bënte njoftim me shkrim dhe e kishin bërë praktikë mënyrën e njoftimit me telefon, sidomos në rastet e “masave të sigurimit”, kur koha nuk premtonte për të bërë njoftim me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

74.6 Komisioni, pasi shqyrtoi prapësimet e subjektit, vëren se ajo nuk e mohon konkluzionin e Komisionit, por e justifikon mosinformimin me shkrim të Drejtorisë Gjyqësore me faktin që çështjet kishin rëndësi të vogël, ndërsa ngjarjet e faktet kishin rrezikshmëri të vogël shoqërore. Pavarësisht nga kjo, udhëzimi nr. ***, datë 14.11.2008, nuk e lidh detyrimin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit për të informuar Drejtorinë Gjyqësore, me rëndësinë e madhe apo të vogël të çështjeve objekt ankimi, prandaj prapësimet e subjektit nuk janë bindëse për Komisionin, por ky i fundit (Komisioni), duke mbajtur në konsideratë numrin e vogël të këtyre rasteve, qëndrimin pranues të kësaj problematike nga ana e subjektit në prapësimet e saj, arrin në përfundimin se këto mangësi në veprimet e subjektit vlerësohen se nuk janë të një rëndësie thelbësore deri në atë pikë sa të mund të cenojnë nivelin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë dhe, për më tepër, që nuk kanë ndikuar në ecurinë e proceseve gjyqësore, qëndrimin e prokurorit të çështjes apo edhe të zgjidhjes së tyre nga gjykata.

75. Çështja penale (viti 2015) në ngarkim të shtetasit L. M. për veprën penale “korrupsion aktiv i punonjësve që ushtrojnë funksione publike” për korrupsionin e punonjësit të pikës kufitare me 500 lekë. Me vendimin nr. ***, datë 15.5.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur dënimin e të pandehurit me 4 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit duke e vënë atë në provë për 18 muaj që të mos kryejë veprë tjetër penale. Kundër vendimit të gjykatës ka ushtruar ankim prokurori i rrethit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit për sa i takon aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal. Prokurori i Apelit ka informuar me shkrim subjektin duke deklaruar mospërfaqësimin e ankimit për shkak se ekzistojnë rrethanat e përcaktuara nga neni 59 i Kodit Penal (rrezikshmëria e paketë e veprës dhe e

të pandehurit, mungesa e precedentëve të mëparshëm, qëndrimi pendues i tij dhe gjendja familjare me 3 fëmijë të mitur).

75.1 Subjekti ka miratuar mospërkrahjen e ankimit nga prokurorja e Apelit dhe ka autorizuar prokurorin e çështjes së shkallës së parë që të marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Në dosje nuk ka informacion të subjektit drejtuar Drejtorisë Gjyqësore për mospërkrahjen e ankimit nga prokurori i Apelit.

Për sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka informuar Drejtorinë Gjyqësore, duke moszbatuar kështu detyrimin e përcaktuar nga pikat 1.1/a dhe 10.1/b të udhëzimit nr. *, datë 14.11.2008.**

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

75.2 Pasi Komisioni i kaloi barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka dhënë shpjegime njësoj si në prapësimet e çështjeve A. C. dhe Xh. F., që trajtojnë përfaqësimin e ankimit në Gjykatën e Apelit mbi bazën e autorizimit të subjektit. Subjekti i bazon prapësimet në: vendimin gjyqësor nr. ***, datë 15.5.2015; apelin e prokurorit datë 21.5.2015; vendimin nr. ***, datë 27.10.2015, të Gjykatës së Apelit Korçë.

Vlerësimi i Komisionit

75.3 Komisioni, pasi mori në shqyrtim prapësimet e subjektit të rivlerësimit, vëren se ato nuk lidhen me rastin konkret, pasi nuk është në rastin kur subjekti duhet të justifikojë se përse i dha prokurorit të rrethit autorizimin për të përfaqësuar apelimin, por është në rastin kur prokurori i Apelit ka refuzuar të mbështesë apelimin e bërë nga prokurori përkatës i rrethit, ka dhënë dorëheqje prej tij dhe subjekti duhej të njoftonte Drejtorinë Gjyqësore për pranimin e kësaj dorëheqjeje. Sipas pikave 1.1/a dhe 10.1/b të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, detyrimi ishte vetëm i subjektit.

Për sa më lart, prapësimet e subjektit nuk qëndrojnë dhe subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me pikat 1.1/a dhe 10.1/b të udhëzimit nr. *, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm.**

1.d) Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në rastet lidhur me përfaqësimin e ankimit jo nga prokurori i Prokurorisë së Apelit, por nga prokurori i çështjes mbi autorizimin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit

76. Çështja penale (viti 2015) në ngarkim të shtetasit A. C. për veprën penale “kontrabandë me mallra të tjerë”. Me vendimin datë 23.6.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur ndaj shtetasit A. C. masën e sigurimit personal “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” edhe pse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier kishte vendosur më parë masën e sigurimit “arrest në burg”, bazuar në të njëjtat fakte e rrethana mbi të cilat vendosi edhe Gjykata Rrethit Gjyqësor Korçë.

76.1 Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë i ka njoftuar¹⁸ subjektit ankimin e prokurores së çështjes kundër vendimit datë 23.6.2015 të Gjykatës së Rrethit

¹⁸Me shkresën nr. ***, datë 25.6.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Gjyqësor Korçë, nëpërmjet të cilit prokurorja ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe caktimin e masës “arrest në burg”.

76.2 Subjekti, me autorizimin nr. *** prot., datë 7.7.2015, ka autorizuar prokuroren e Prokurorisë së Rrethit Korçë që të përfaqësojë ankimin e saj në Gjykatën e Apelit, duke cituar se *Prokuroria e Apelit ka vlerësim të ndryshëm nga apelimi i prokurores së rrethit, ku kjo e fundit është dakord të përfaqësojë ankimin në Gjykatën e Apelit*, por subjekti nuk ka parashtruar në autorizim apo në ndonjë dokument tjetër arsyet përse ka këtë vlerësim të ndryshëm.

76.3 Në përmbajtjen e ankimit të nënshkruar nga prokurorja e rrethit nuk rezulton që në këtë ankim ajo të ketë shprehur vullnetin për të marrë pjesë në gjykimin pranë Gjykatës së Apelit, siç përcakton pika 2.1 e udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008. Vetëm në këtë rast subjekti kishte të drejtë sipas pikës 2.2 të këtij udhëzimi, që të autorizonte prokuroren e rrethit të përfaqësonte ankimin në Apel.

76.4 Me kërkesën datë 7.7.2015, drejtuar Gjykatës së Apelit Korçë, ka hequr dorë nga ankimi edhe vetë prokurorja e rrethit që kishte paraqitur ankimin, duke arsyetuar se: *“...referuar qëndrimin të mbajtur nga Prokuroria e Apelit, por edhe kushteve dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, masa e sigurimit e caktuar nga gjykata i përlligj nevojat e sigurimit në këtë fazë të hetimit”*.

76.5 Nga aktet që subjekti ka dërguar pranë Komisionit nuk rezulton që sipas pikës 9.1/b të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të ketë një informacion të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë (subjektit të rivlerësimit), në lidhje me arsyet përkatëse të heqjes dorë prej apelit nga ana e prokurores së çështjes dhe pranimin e kësaj dorëheqjeje. Gjithashtu, nuk rezulton që sipas pikës 10.2 të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të ketë njoftim nga prokurorja e çështjes në Prokurorinë e Rrethit Korçë drejtuar Drejtorisë Gjyqësore në lidhje me mënyrën e përfundimit të çështjes. Në lidhje me këto veprime të prokurorëve më të ulët nuk rezulton që të ketë as njoftim të subjektit të rivlerësimit, drejtuar Drejtorisë Gjyqësore, në referim të pikës 10.1/e të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008.

76.6 Për sa më lart, Komisioni arriti në konkluzionin se:

- Janë të paqarta arsyet përse subjekti ka refuzuar të mbështesë ankimin e prokurores së rrethit dhe përse e ka autorizuar atë që të përfaqësojë ankimin gjatë gjykimin në Gjykatën e Apelit Korçë, duke i lënë kështu asaj hapësirë veprimi që të hiqte dorë nga ankimi i saj gjatë gjykimin në Gjykatën e Apelit Korçë.

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka njoftuar Drejtorinë Gjyqësore, në referim të pikës 10.1/e të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008.

- Nisur nga këto veprime, duke i parë në harmoni me njëra-tjetrën si: mosankimimi nga Prokuroria e Apelit Korçë; mungesa e transparencës së qëndrimit të saj në lidhje me ankimin e Prokurorisë së Rrethit Korçë; heqja dorë nga ankimi prej prokurores së çështjes e ndikuar nga qëndrimi i Prokurorisë së Apelit Korçë; qëndrimi indiferent i subjektit në lidhje me veprimet e prokurorëve më të ulët (prokurorit të çështjes dhe drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Korçë), Komisioni ngre dyshime se subjekti ka

favorizuar të ndaluarin, duke krijuar mundësinë e lehtësimit të masës së sigurimit ndaj tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

76.7 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo çështje është relatuar në Apel nga prokurorja e çështjes e rrethit, pasi është diskutuar me drejtuesin e Prokurorisë së Rrethit Korçë. Prokurorja e çështjes ka shprehur vullnetin për të përfaqësuar çështjen në Gjykatën e Apelit Korçë mbi autorizimin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit. Në seancën gjyqësore, kjo prokurore ka deklaruar dorëheqjen dhe Gjykata e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit.

76.8 Autorizimi është zgjidhur drejt sipas përcaktimit të nenit 408, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, por mënyra se si ishte parashikuar rasti i autorizimit të prokurorit të çështjes për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, në pikën 2 të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, vinte ndesh me rregullimin ligjor të nenit 408, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale dhe praktikisht i paaplikueshëm. Forma e aktit të apelit është përcaktuar në nenin 412 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk mund të ndërhyhet në këtë akt me artificat e një udhëzimi që në këtë pikë rezulton ekstraprocedural (pika 2 e udhëzimit). Atëherë, praktikisht, Drejtoria e Gjyqësorit dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku gjendej çështja, ranë dakord që kjo dispozitë të aplikohet në këtë mënyrë: në ato raste kur prokurori i Apelit kishte qëndrim të ndryshëm me qëndrimin e prokurorit të seancës, çështja diskutohej me prokurorin e çështjes dhe drejtuesin e prokurorisë përkatëse për problematikën dhe qëndrimin e ndryshëm të prokurorisë së Apelit ndaj çështjes së apeluar dhe kur binte dakord me prokurorin e çështjes bëhej autorizimi për të marrë pjesë ai në gjykimin e çështjes pranë Gjykatës së Apelit.

76.9 Në asnjë rast nuk bëhej autorizim pa vullnetin e prokurorit dhe pa rënë dakord për të marrë pjesë në gjykim. Kjo praktikë e konsoliduar në rastet e autorizimeve, në asnjë rast nuk është konstatuar si shkelje në të dyja shkallët e prokurorisë nga kontrolltet që ka bërë Prokuroria e Përgjithshme apo edhe nga informimet e rasteve të veçanta pranë saj.

76.10 Në këto raste drejtuesi i Prokurorisë së Apelit nuk kishte asnjë detyrim sipas udhëzimit për të informuar në Drejtorinë Gjyqësore sepse neni 25, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale parashikon që në seancë gjyqësore prokurori i ushtron funksionet e tij në pavarësi të plotë dhe po ashtu sipas pikës 10.2 të udhëzimit, detyrimi për të informuar pranë Drejtorisë Gjyqësore ka qenë vetëm i prokurorit që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit me autorizim. Pika 10.2 e udhëzimit përcakton në mënyrë eksplicite *“Në përfundim, prokurori i autorizuar duhet të informojë Drejtorinë Gjyqësore mbi mënyrën e përfundimit të çështjes menjëherë pas përfundimit të saj”*.

76.11 Për sa më lart, subjekti pretendon se sjellja e saj nuk është në kundërshtim me udhëzimin nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm.

76.12 Në vijim, subjekti shpjegon se: *“Dyshimi i Komisionit për çështjen A. C. nuk gjen mbështetje në asnjë akt të këtij procedimi. Qëndrimi i Prokurorisë së Apelit ka*

qenë i qartë, ligjor, transparent dhe nuk kemi hequr dorë nga apeli (për të favorizuar të dyshuarin), por i kam dhënë mundësi prokurores së çështjes si prokurore apeli nëpërmjet autorizimit që vetë ajo të përfaqësojë këtë çështje në Gjykatën e Apelit. Vetëm një rezultat pozitiv që mund të merrej në Gjykatën e Apelit do të ishte kompromentues për prokurorin e Apelit dhe vlerësim shumë negativ për këtë të fundit”.

76.13 Prapësimet subjekti i mbështet në provat bashkëlidhur si: vendimi nr. ***, datë 23.6.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ndaj të dyshuarit S. Xh.; vendimi datë 13.11.2015, “Për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2015”, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë në ngarkim të shtetasve S. Xh. dhe A. C.; vendimi nr. ***, datë 23.6.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ndaj shtetasit A. C.; vendimi nr. ***, datë 9.7.2015, i Gjykatës së Apelit Korçë.

Vlerësimi i Komisionit

76.14 Në lidhje me lëshimin e autorizimit nga subjekti i rivlerësimit për përfaqësimin e akuzës në Gjykatën e Apelit nga prokurori që kishte përfaqësuar akuzën në shkallë të parë, Komisioni i gjen bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

76.15 Siç ka shpjeguar më lart subjekti, sipas pikës 10.2 të udhëzimit, detyrimi për të informuar pranë Drejtorisë Gjyqësore ka qenë vetëm i prokurorit të rrethit që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit me autorizim. Gjithashtu, ka qenë detyrimi i drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit që të informonte me shkrim drejtuesin e Prokurorisë së Apelit, duke parashtruar arsyet përkatëse kur pranon dorëheqjen e prokurorit të seancës nga apeli e duke parashtruar edhe qëndrimin e tij për këtë heqje dorë.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se në veprimet e subjektit të rivlerësimit në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë, nuk konstatohen mangësi që mund të ngarkojnë atë me përgjegjësi në lidhje me kriterin e aftësive profesionale.

77. Çështja penale (viti 2014) në ngarkim të shtetasit Xh. F. për veprën penale “dhunë në familje”. Sipas ankimit nr. ***, datë 26.5.2015, të prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Korçë rezulton se gjatë gjykimin të shkurtuar prokurori i çështjes ka kërkuar dënimin e të pandehurit me 4 muaj burgim. Me vendimin nr. ***, datë 21.5.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi dënimin me 4 muaj burgim, por pezulloi ekzekutimin e dënimit dhe caktoi vënien në periudhë prove për 18 muaj.

Me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2015, “Heqje dorë nga ankimi kundër vendimit nr. ***, datë 21.5.2015” të nënshkruar nga prokurori i çështjes dhe nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit, njoftohet subjekti i rivlerësimit për heqjen dorë nga ankimi, por pa paraqitur aty arsyet e heqjes dorë.

77.1 Në prapësimet e saj, subjekti ka depozituar: vendimin nr. ***, datë 21.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; autorizimin për pjesëmarrje në gjykim të prokurorit të çështjes datë 26.10.2015; aktin “heqje dorë nga ankimi” të prokurorit të çështjes, konfirmuar nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit datë 27.10.2015; vendimin nr. ***, datë 12.11.2015, të Gjykatës së Apelit Korçë, etj.

77.2 Bazuar në provat që subjekti i ka bashkëlidhur prapësimeve, Komisioni vëren se me autorizimin nr. ***, datë 26.10.2015, subjekti ka autorizuar prokurorin e rrethit që të përfaqësojë organin e akuzës gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Korçë, për shkak se Prokuroria e Apelit Korçë kishte qëndrim të kundërt me apelin e prokurorit të rrethit. Në këto kushte, përgjegjësia për të njoftuar Drejtorinë Gjyqësore për dorëheqjen nga ankimi është e prokurorit të rrethit në bazë të pikës 10.2 të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Çështje kur subjekti ka informuar Drejtorinë Gjyqësore për pranimin e refuzimit të prokurorit të Gjykatës së Apelit për ushtrimin e rekursit sipas pikave 10.1/a, 1.1/a dhe 1.1/d të udhëzimit nr. *, datë 14.8.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm**

78. Çështja penale (viti 2015) në ngarkim të shtetasit K. Q. për veprën penale “shpërdorim detyre”. Me vendimin nr. ***, datë 21.4.2015, Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 24.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për dënimin me 5 muaj burgim të shtetasit K. Q., por duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe vendosjen në kohë prove për 18 muaj. Gjatë gjykimit në Apel, Prokuroria e Apelit Korçë ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 24.11.2014, por më pas prokurorja e apelit ka informuar me shkrim subjektin dhe i shpjegon se e konsideron të drejtë vendimin e Gjykatës së Apelit, pasi ekzistojnë kriteret për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, prandaj nuk ekzistojnë shkaqe ligjore për rekurs. Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2015, subjekti ka informuar Drejtorinë e Gjyqësorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

79. Çështja penale në ngarkim të shtetasit N. H. për veprën penale “korrupsion aktiv i punonjësve që ushtrojnë funksione publike” me anë të shumës 500 euro për të kaluar kufirin grek, pasi nuk kishte fletë garancie për në Greqi. Me vendimin nr. ***, datë 21.10.2015, Gjykata e Apelit Korçë, pasi ka gjykuar mbi ankimin e prokurorit të rrethit, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 15.5.2015, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit: në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin me 4 muaj burgim; në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe vënien në kohë prove për 18 muaj. Gjatë gjykimit në Apel, prokurorja e Apelit ka përkrahur ankimin e prokurorit të rrethit, duke kërkuar mosaplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, por pas përfundimit të gjykimit ajo ka informuar me shkrim subjektin në lidhje me çështjen dhe duke shpjeguar se masa e dënimit e caktuar nga gjykatat është brenda kriterëve ligjore të nenit 59 të Kodit Penal, sugjeron se nuk ka shkaqe ligjore për rekurs. Pasi subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurores, me shkresën nr. *** prot., datë 6.11.2015, ka informuar Drejtorinë e Gjyqësorit në Prokurorinë e Përgjithshme.

80. Çështja penale në ngarkim të shtetasit K. H. për veprën penale “korrupsion aktiv i punonjësve që ushtrojnë funksione publike”. Me vendimin nr. ***, datë 31.3.2015, Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 7.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke vlerësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të të pandehurit dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

80.1 Gjatë gjykimit në apel, prokurorja e Apelit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, por pas gjykimit ajo ka informuar me shkrim subjektin duke sugjeruar se referuar arsyetimit të Gjykatës së Apelit, të cilin e gjen të drejtë, ekzistojnë rrethana që tregojnë rrezikshmërinë e paket të personit dhe të veprës penale dhe jo domosdoshmërisht duhet të aplikohet masa e sigurimit “arrest në burg”, prandaj nuk është rasti për të bërë rekurs. Pasi subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurores, me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2015, ka informuar Drejtorinë e Gjyqësorit në Prokurorinë e Përgjithshme.

81. Çështja penale në ngarkim të shtetasit E. A. E. për caktim mase sigurimi për efekt ekstradimi. Me vendimin nr. ***, datë 12.3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg për një muaj”. Vendimi u ankimua nga i arrestuari dhe në Gjykatën e Apelit Korçë çështja u përfaqësua nga prokurorja e Apelit Korçë, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 12.3.2015.

81.1 Me vendimin nr. ***, datë 2.4.2015, Gjykata e Apelit Korçë vendosi: ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 12.3.2015 dhe revokimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për shkak të mbarimit të afateve të masave shtrënguese të përcaktuara në nenin 493/4 të Kodit të Procedurës Penale; lirim të arrestuarit; bllokimin e pasaportës së tij deri në përfundim të gjykimit të kërkesës për ekstradim; dhe urdhërimin e policisë gjyqësore të marrë masat për moslejimin e të arrestuarit që të dalë jashtë territorit të Shqipërisë.

81.2 Prokurorja e apelit ka informuar me shkrim subjektin se vendimi i gjykatës së apelit është i drejtë dhe ka sugjeruar që nuk ekzistojnë shkaqe ligjore për rekurs. Pasi subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurores, me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2015, ka informuar Drejtorinë e Gjyqësorit në Prokurorinë e Përgjithshme, në zbatim të pikave 10.1/a dhe 1.1/d të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008.

82. Çështja penale (viti 2016) në ngarkim të shtetasit I. M. për veprën penale “kultivim i lëndëve narkotike”. Me vendimin nr. ***, datë 28.12.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vendosur: deklarinim fajtor të të pandehurit; dënimin me 2 vjet burgim në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale; dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe vënien në provë për 18 muaj në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal. Kundër vendimit ka ushtruar ankim prokurori i çështjes duke kërkuar mosaplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.

82.1 Me vendimin nr. ***, datë 19.4.2016, Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 28.12.2015, duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit për pjesën e mbetur të dënimit, pasi i pandehuri kishte vuajtur pjesën më të madhe të dënimit në burg për shkak të masës së sigurimit “arrest në burg”.

82.2 Prokurorja e apelit informon me shkrim subjektin, duke shpjeguar se masa e dënimit dhe alternativa e ekzekutimit të tij që janë dhënë nga dy gjykatat janë në përputhje me dispozitat procedurale, sidomos me rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e të pandehurit, i cili nuk ka pasur precedentë të mëparshëm penalë dhe e ka pranuar kryerjen e veprës penale, prandaj nuk ekzistojnë shkaqet për ushtrimin e rekursit.

Subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurores dhe ka informuar¹⁹ me shkrim Drejtorinë e Kontrollit të Hetimit, Ndjekjes Penale, Përfaqësimit në Gjykim dhe Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Komisioni në 5 rastet më lart nuk konstatoi mangësi në ushtrimin e detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë.

*3. Çështje kur subjekti nuk kishte detyrimin të informonte Drejtorinë Gjyqësore, nëse pranonte refuzimin e prokurorit të Gjykatës së Apelit për ushtrimin e rekursit sipas pikës 10.1/a për rastet e parashikuara nga paragrafët 1.1 dhe 1.3 të udhëzimit nr. ***, datë 14.8.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe nuk ishte në rastet e detyrimit për të bërë rekurs siç parashikon pika 6 e këtij udhëzimi*

83. Çështja penale (viti 2014) në ngarkim të shtetasit M. J. për veprën penale “prishje e qetësisë publike”. Prokurori i Apelit ka përfaqësuar akuzën në Gjykatën e Apelit Korçë duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 4.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ndaj të cilit ka paraqitur ankim i pandehuri dhe kundërankim prokurori i rrethit. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ***, datë 5.12.2014, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 4.6.2014, me ndryshimin që dënimi me 2 muaj burgim të zëvendësohet me gjobë në vlerën 66,666 lekë, me arsyetimin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë në përcaktimin e masës së dënimit nuk ka mbajtur parasysh rrethanat lehtësuese.

83.1 Prokurori i Apelit i ka dërguar subjektin informacionin datë 5.12.2014, ku citon se ai pajtohet me vendimin e Gjykatës së Apelit dhe heq dorë nga rekursi sepse nuk ekzistojnë shkaqet ligjore për të paraqitur rekurs dhe as nuk është në kushtet e detyrimit për të ushtruar rekurs në bazë të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm. Subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurorit të paraqitur në informacion.

83.2 Për sa më lart, qëndrimi i subjektit është i drejtë dhe nuk gjendet në asnjë nga rastet e përcaktuara nga pika 6 e udhëzimit të lartpërmendur, të cilat e detyrojnë drejtuesin e Prokurorisë së Apelit që të ushtrojë rekurs pavarësisht nga qëndrimi i prokurorit të Apelit.

84. Çështja penale (viti 2014) në ngarkim të shtetasit M. Xh. për veprën penale “vjedhje”. Me vendimin nr. ***, datë 27.6.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, pas gjykimit të shkurtuar, ka vendosur dënimin e tij me 2 vjet burgim. Vendimi është ankimuar nga i pandehuri. Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit, prokurori i Apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 27.6.2014. Me vendimin nr. ***, datë 2.12.2014, Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 27.6.2014, me ndryshimin e masës së dënimit, nga 2 vjet në 1 vit burgim (1 vit burgim e 6 muaj kishte kërkuar edhe prokurori i rrethit gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Pogradec).

84.1 Prokurori i Apelit i ka paraqitur subjektin informacionin datë 5.12.2014, ku midis të tjerash shprehet se nuk ekzistojnë shkaqet ligjore për të paraqitur rekurs dhe as nuk

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2016, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.

është në kushtet e detyrimit për të ushtruar rekurs në bazë të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm. Subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurorit të paraqitur në informacion.

85. Çështja penale (viti 2014) në ngarkim të shtetasit A. B. për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”. Me vendimin nr. ***, datë 5.12.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vendosur vlerësimin e ligjshëm të masës “arrest në flagrancë” të shtetasit A. B., caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe lirimin e menjëhershëm të tij nga dhomat e paraburgimit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim prokurori i rrethit, duke kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

85.1 Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Korçë, prokurorja e apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si prokurori i rrethit në ankim, ndërsa Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 30.12.2014, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 5.12.2014.

85.2 Prokurori i Apelit i ka paraqitur subjektin informacionin në lidhje me këtë çështje ku, midis të tjerash, shpjegon se mendon që nuk duhet të ushtrohet rekurs, si dhe ka renditur shkaqet e refuzimit të rekursit midis të cilave edhe mungesa e rrezikshmërisë së autorit të veprës penale në kuptim të nenit 230/1 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurorit të paraqitur në informacion.

86. Çështja penale (viti 2015) ndaj të ndaluarit A. A. për veprën penale “mashttrim”. Me vendimin nr. ***, datë 7.1.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin e tij dhe ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg” për 40 ditë. Vendimi është ankimuar nga i arrestuari. Në gjykimin nga Gjykata e Apelit, ankimi është përkrahur nga prokurorja e Apelit, por pas përfundimit të gjykimit kjo prokurore ka vlerësuar se është i drejtë vendimi nr. ***, datë 27.1.2015, i Gjykatës së Apelit që ka vendosur vlerësimin e paligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim paraqitjeje para oficerit të policisë gjyqësore”, për shkak se nuk ekzistojnë rrethanat dhe kriteret e arrestimit të ligjshëm dhe as të nevojës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

86.1 Prokurorja i ka paraqitur informacion me shkrim subjektit duke sugjeruar se nuk ekzistojnë shkaqet ligjore për rekurs dhe subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurores.

87. Çështja penale (viti 2016) në ngarkim të shtetasit L. N. për veprën penale “vjedhje” e një celulari. Me vendimin nr. ***, datë 10.3.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur vlerësimin si të paligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit L. N. dhe caktimin e masës së sigurimit personal “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim prokurori i rrethit, i cili ka kërkuar vlerësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Në lidhje me masën e sigurimit, prokurori ka pretenduar se masa e sigurimit “detyrim për paraqitje” nuk është në përputhje me rrezikshmërinë e të ndaluarit, i cili paraqet një rrezikshmëri të lartë shoqërore për faktin se është dënuar edhe më parë për vjedhje.

87.1 Me vendimin nr. ***, datë 19.4.2016, Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 10.3.2016, duke argumentuar se nuk janë kushtet e nenit 251 dhe 252 të Kodit të Procedurës Penale. Prokurorja e Apelit ka informuar më shkrim

subjektin për zhvillimin e gjykimit në shkallë të dytë, duke sugjeruar të mos ushtrohet rekurs për disa arsye, por midis të tjerash edhe sepse pavarësisht se personi i ndaluar është përsëritës i veprës penale, referuar rëndësisë së faktit nuk rezulton rrezikshmëri e veçantë e veprës penale që të ndikojë patjetër në dhënien e masës së sigurimit “arrest në burg”. Subjekti ka miratuar qëndrimin e prokurores për të mos ushtruar rekurs.

87.2 Komisioni vëren se për këtë çështje subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në rastet e detyrimit për të ushtruar rekurs, të parashikuara nga pikat 5.1 dhe 5.2 të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008.

Komisioni në 5 raste si më lart nuk konstatoi mangësi në ushtrimin e detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë.

*4. Çështje në lidhje me mosinformimin e Drejtorisë Gjyqësore, kur subjekti pranon refuzimin e prokurorit të Gjykatës së Apelit për ushtrimin e rekursit sipas pikës 10.1/a për rastet e parashikuara nga paragrafët 1.1 dhe 1.3 të udhëzimit nr. ***, datë 14.8.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm*

88. Çështja penale (viti 2014) në ngarkim të shtetasit A. H. për veprën penale “drejtim automjeti në mënyrë të parregullt” në gjendje të dehur dhe pa leje drejtimi automjeti. Prokurori i Apelit në Gjykatën e Apelit Korçë ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 7.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi këtë vendim me ndryshimin që dënimi me burgim prej 14 ditësh të zëvendësohet me 60 orë pune në interes publik dhe mbajtjen e kontaktit me Shërbimin e Provës.

88.1 Prokurori i Apelit i ka dërguar subjektit informacionin datë 26.11.2014, ku citon se ai pajtohet me vendimin e Gjykatës së Apelit dhe heq dorë nga rekursi sepse nuk ekzistojnë shkaqet ligjore për të paraqitur rekurs dhe as nuk është në kushtet e detyrimit për të ushtruar rekurs në bazë të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm.

88.2 Subjekti nuk ka qenë në rastet e pikës 6 të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të cilat e detyrojnë drejtuesin e Prokurorisë së Apelit të ushtrojë rekurs pavarësisht nga qëndrimi i prokurorit të Apelit, prandaj ka sigluar në informacion dakordësinë e tij me qëndrimin e prokurorit të apelit, të paraqitur, por në dosje nuk ka informacion të subjektit drejtuar Drejtorisë Gjyqësore për miratimin e dorëheqjes së prokurorit të Apelit nga rekursi.

89. Çështja penale (viti 2014) në ngarkim të shtetasit B. B. për veprën penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt” pa leje qarkullimi për motoçikletë. Me vendimin nr. ***, datë 4.6.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vendosur pas gjykimit të shkurtuar deklarinimin fajtor dhe dënimin e tij me 20 ditë burgim. I pandehuri ka ankimuar këtë vendim duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe aplikimin e alternativave të dënimit sipas nenit 63 të Kodit Penal (kryerja e punës në interes publik), siç e kishte kërkuar edhe prokurori i rrethit gjatë gjykimit.

89.1 Me vendimin nr. ***, datë 4.11.2014, Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 4.6.2014, me ndryshimin që dënimi me 20 ditë burgim të zëvendësohet me 60 orë pune në interes publik dhe mbajtjen e kontaktit me Shërbimin e Provës.

89.2 Prokurori i Apelit i ka paraqitur subjektit informacionin datë 7.11.2014, ku midis të tjerash shprehet se pajtohet me vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë sepse nuk ekzistojnë shkaqet ligjore për të paraqitur rekurs sipas Kodit të Procedurës Penale dhe as nuk është në kushtet e detyrimit për të ushtruar rekurs në bazë të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm. Subjekti ka rënë dakord me qëndrimin e prokurorit të paraqitur në informacion, por në dosje nuk ka informacion të subjektit drejtuar Drejtorisë Gjyqësore për miratimin e refuzimit të prokurorit të Apelit për ushtrim rekursi.

Për sa më lart, në këto dy çështje duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka informuar Drejtorinë Gjyqësore duke moszbatuar kështu detyrimin e përcaktuar nga pikat 10.1/a dhe 1.1/a të udhëzimit nr. *, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm.**

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

89.3 Në prapësime subjekti ka shpjeguar se në këto raste, çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Korçë mbi bazën e apelit të të pandehurit dhe ndryshimet në vendim janë bërë nga kjo gjykatë. Në këto raste, drejtuesi i Prokurorisë së Apelit nuk ka detyrimin për të informuar sepse nuk gjendet në pikën 1.1/a të udhëzimit, si dhe në parashikimet e pikave 6.1/a dhe 6.1/b të udhëzimit.

Vlerësimi i Komisionit

89.4 Komisioni ka konkluduar se në zbatim të pikave 10.1/a dhe 1.1/a të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti duhej të informonte Drejtorinë Gjyqësore qoftë edhe për të parashtruar arsyet përse miratoi dorëheqjen e prokurorit të Apelit nga rekursi. Pika 10.1/a nuk e lidh detyrimin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit për të informuar Drejtorinë Gjyqësore me kërkimet që bën prokurori i seancës gjatë gjykimit në shkallën e parë. Ky detyrim lidhet me situatën kur drejtuesi i Prokurorisë së Apelit pranon refuzimin e prokurorit të apelit për të bërë rekurs në rastet kur gjykata e shkallës së parë ka dhënë vendim të kundërt me kërkimet e prokurorit të seancës gjatë gjykimit në shkallë të parë, raste këto të përcaktuara nga pika 1.1 e Udhëzimit.

89.5 Megjithatë, në referim të pikës 6.1 të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, marrë shkas nga fakti që ankimi është bërë nga i pandehuri, fakti që për këto çështje nuk janë rastet e pikës 6.1 kur prokurori i apelit detyrohet të ushtrojë rekurs, masa e dënimit dhe rrezikshmëria e veprës është e ulët, këto mangësi në veprimet e subjektit nuk vlerësohen si thelbësore në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë.

90. Çështja penale (viti 2015) në ngarkim të shtetasit R. Sh. për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”. Nga përmbajtja e vendimit nr. ***,

datë 1.7.2014, të Gjykatës së Apelit Korçë, që ndodhet në dosje rezulton se me vendimin nr. ***, datë 1.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, pas gjykimit të shkurtuar e ka deklaruar fajtor të pandehurin, e ka dënuar me 3 muaj burgim dhe ka aplikuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit, duke e vendosur në periudhë prove 18 muaj. Prokurori i çështjes ka ankimuar vendimin duke kërkuar të mos aplikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit. Në Gjykatën e Apelit ankimi është përkrahur nga Prokuroria e Apelit Korçë, por Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 16.1.2015, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 1.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke argumentuar se ekzistojnë rrethanat për të aplikuar nenin 59 të Kodit Penal mbi pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

90.1 Sipas informacionit me shkrim prokurorja e Apelit informon subjektin për çështjen dhe sugjeron të mos ushtrohet rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit. Subjekti ka miratuar mosushtrimin e rekursit, por nuk ka informuar Drejtorinë Gjyqësore për refuzimin e rekursit.

Për sa më lart, duket se subjekti nuk ka informuar Drejtorinë Gjyqësore për refuzimin e rekursit, duke shkelur kështu pikat 10.1/a dhe 1.1/a të udhëzimit nr. *, datë 14.11.2008.**

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

90.2 Subjekti i rivlerësimit ka dhënë prapësimet se në lidhje me informimin e Drejtorisë Gjyqësore në rastet e mosushtrimit të rekursit, kur ishte përkrahur apeli i prokurorit, por apelimi nuk ishte pranuar nga Gjykata e Apelit, informimi bëhej verbalisht duke pasur parasysh rastin që i pandehuri kishte rrezikshmëri të pakët shoqërore, vepra penale jo të rëndësishme dhe masa e dënimit e ulët me aplikim të nenit 59 të Kodit Penal dhe, për pasojë, subjekti pretendon se veprimet e saj nuk kanë sjellë asnjë pasojë lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Vlerësimi i Komisionit

90.3 Komisioni i merr në konsideratë arsyet që parashtron subjekti në lidhje me rrezikshmërinë e vogël shoqërore, llojin e veprës penale dhe masën e ulët të dënimit, por kjo nuk e justifikon informimin verbal që ka bërë subjekti, pasi pika 10.1/a e udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, ka përcaktuar qartë që drejtuesi i Prokurorisë së Apelit duhet të njoftojë me shkrim.

Për sa më lart, Komisioni konstaton mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit, por duke mbajtur në konsideratë qëndrimin pranues të subjektit në prapësimet e saj në lidhje me këtë problematikë arrin në përfundimin se këto mangësi nuk janë të një rëndësie thelbësore, aq thelbësore sa të penalizojnë subjektin e rivlerësimit në aspektin e aftësive të saj profesionale, në ushtrimin e detyrës në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë.

91. Çështja penale (viti 2016) në ngarkim të shtetasit S. V. për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”. Me vendimin nr. ***, datë 4.7.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur vlerësimin si të paligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit S. V. dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi”

për 30 ditë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim prokurori i rrethit, i cili ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, ndërsa i arrestuari ka paraqitur kundërankim.

91.1 Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Korçë ankimi është përkrahur nga prokurorja e Apelit. Me vendimin nr. ***, datë 29.7.2016, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 4.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë vlerësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të të ndaluarit në përputhje me nenin 251 të Kodit të Procedurës Penale dhe caktimin si masë sigurimi personal “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

91.2 Prokurorja e Apelit informon me shkrim subjektin duke shpjeguar arsyet pse është dakord me vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë. Subjekti e ka miratuar qëndrimin e prokurores. Në dosje nuk ka informacion të subjektit drejtuar Drejtorisë Gjyqësore në lidhje me miratimin e qëndrimit të prokurores së çështjes për të mos ushtruar rekurs.

Për sa më lart, Komisioni vëren se subjekti nuk i ka dërguar informacion me shkrim Drejtorisë Gjyqësore, në zbatim të pikave 10.1/a dhe 1.1/d të udhëzimit nr. *, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm.**

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

91.3 Në prapësime subjekti ka shpjeguar se për këtë rast prokurori i Apelit nuk ka detyrimin për të informuar sepse nuk gjendet në kushtet e pikës 1.1 të udhëzimit, meqë vepra penale për të cilën ka filluar procedimi parashikon dënimin me gjobë në minimum dhe jo 3 vjet burg siç parashikohet në pikën 1.1/d të udhëzimit, rregullim mbi të cilin fillon edhe detyrimi i drejtuesit të Prokurorisë së Apelit sepse nuk gjendet në pikën 10.1/a.

Vlerësimi i Komisionit

91.4 Komisioni vlerëson se referuar pikës 1.1/d të udhëzimit, prapësimi i subjektit të rivlerësimit qëndron.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se në veprimet e subjektit nuk konstatohen mangësi.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

92. Për sa më lart, rezultuan 3 raste kur subjekti nuk ka respektuar pikat 10.1/a dhe 1.1/a të udhëzimit nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe 3 raste kur nuk ka respektuar pikat 10.1/b dhe 1.1/a të këtij udhëzimi, por duke mbajtur në konsideratë numrin dhe rëndësinë e pakët të çështjeve dhe masës së dënimit për ato, rrezikshmërinë e vogël shoqërore të të pandehurve, qëndrimin pranues të subjektit mbi problematikat, në prapësimet e saj, Komisioni arrin në përfundimin se këto mangësi në veprimet e subjektit nuk janë të një rëndësie thelbësore deri në atë masë sa të penalizojnë aspektin e aftësive të saj profesionale.

93. Referuar analizës së raportit të hartuar nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues vlerëson se në vështirimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje serioze e të përsëritura të natyrës procedurale, gabime thelbësore apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e veprimeve hetimore dhe vlerësimit të çështjeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES

94. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar nenit DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, kreut V, VI dhe VII të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Irma Balli:

- a. lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës rezultoi se ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- b. lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale;
- c. në vlerësimin tërësor të çështjes nuk ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/a të nenit 58, të pikave 1/b dhe 1/c të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Irma Balli, prokurore/Drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 23.1.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Olsi KOMICI
Relator

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj